

*të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet”.*

Gjykata vlerëson se, nga hetimet e kryera dhe provat e përftuara, plotësohet kushti i parë universal i masave të sigurimit, të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova. Ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova dëshmon për plotësimin e kushtit themelor të përgjithshëm për caktimin e masave të sigurimit personal, i parashikuar si i tillë në nenin 228 pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, me përmbajtjen: *“Askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova”*. Në arritjen e konkluzionit të mësipërm, gjykata mbajti parasysh edhe arsyetimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues Nr.7 datë 14.10.2011, sipas të cilit: *“...dyshimi i arsyeshëm, provat ku ai bazohet për të justifikuar caktimin dhe vijimin e zbatimit të masës së sigurimit, nuk nevojitet të ketë të njëjtën shkallë sigurie dhe vlerë provueshmërie për të konkluduar sikurse provat që janë të domosdoshme për dhënien ose jo të vendimit të dënimit ndaj të pandehurit. Mjafton që ato të jenë të tilla që, në gjendjen ku janë aktet e procedimit, prej tyre mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit a të gjykuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie e fajësisë për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij...”*.

Analiza në tërësi e të gjitha provave të marra në përputhje me ligjin procedural penal, vlerësohet nga gjykata për të krijuar dyshimin e arsyeshëm në përputhje me këto prova të cilat provojnë: Përfshirjen e personave nën hetim në kryerjen e veprave penale respektive që i atribuohen. Të vlerësuara në tërësinë e tyre provat e analizuara më sipër, provojnë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në prova, se duket e mundshme përgjegjësia e personave nën hetim në lidhje me dyshimin e kryerjes së veprave penale më sipër, për sa do të analizohet në vijim:

Gjykata do të parashtrojë në mënyrë të përmbledhur dhe kronologjike rrethanat e faktit, si dhe të gjitha veprimet e kryera nga ana e shtetasve nën hetim Jamarbër Malltezi, Fatmir Bektashi dhe Sali Berisha. Ky i fundit, në cilësinë e tij si Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, ka kryer veprime të materializuara nëpërmjet miratimit të akteve ligjore epo nënligjore, me qëllim përshtatjen e tyre sipas nevojave që paraqiteshin për pesë familjet ish-pronare, ku fitues i drejtëpërdrejtë rezultonte të ishte bashkëshorti i vajzës së tij, shtetasi Jamarbër Malltezi.

Më konkretisht, nga të dhënat e përftuara me shkresën nr. 9549/3 prot datë 14.11.2005, Ministri i Mbrojtjes Fatmir Mediu, i parashtroi Ministrin të Ekonomisë, Genç Ruli, se: *... propozojnë miratimin e privatizimit të objekteve dhe terreneve sportive të Klubit të Futbollit “Partizani” ...*

Me shkresën nr. 48/1 prot datë 16.01.2006 Ministria e Mbrojtjes (Kabineti), shkresë e nënshkruar nga Shefi i Kabinetit, Prof. Ass. Dr. Elmaz Leci, i është drejtuar bashkësisë *“Kroi i Shëngjinit”* ku bëhet me dije se: *... Klubi Sportiv Partizani nuk përfshihet në planin e përhapjes së FA dhe për këtë arsye MM i ka kërkuar METE miratimin e privatizimit të objekteve të këtij klubi. ...*

Pas konfirmimit të mësipërm, shtetasit Jamarbër Malltezi, bashkëshorti i shtetases Argita Malltezi (vajza e kryeministrit të Republikës së Shqipërisë në këtë kohë, shtetasit Sali Berisha), i jepen tagra përfaqësimi, nga trashëgimtarët ligjorë të familjeve pronare, për t’u lidhur me firma ndërtuese apo përfaqësim në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, sipas prokurave respektive me nr. 787 rep nr. 142 kol datë 31.01.2006, nr. 2165 rep nr. 248 kol datë 03.05.2006, nr. 4209 rep nr. 742 kol datë 09.05.2006 (Xhimi Begeja),

nr. 2442 rep nr. 304 kol 18.05.2006 (Ilir Kadiu). Në këmbim të shërbimeve të përfaqësimit që do të realizohet shtetasi Jamarbër Malltezi, trashëgimtarët ligjorë të familjeve pronare vënë në dispozicion të këtij të fundit, 3 – 5% të pasurisë së tyre të paluajtshme, për krijimin e një fondi rezervë për përballimin e shpenzimeve emergjente dhe të paparashikuara. Megjithatë, nisur nga tagrat e dhëna, që është lidhja me firma ndërtuese apo nënshkrimi i kontratës së parë që vë në dispozicion firma ndërtuese për truallin e tyre, nuk rezultojnë e qartë se cilat do të ishin shpenzimet emergjente dhe të paparashikuara, në kuadër të të cilave do të jepeshin shtetasit Jamarbër Malltezi këto pjesë të pasurive së paluajtshme.

Për më tepër, rezultojnë se firma ndërtuese shtetasit Fatmir Bektashi, trashëgimtari i një prej familjeve pronare, i cili ka interes në ndërtime të mundshme në këto teritore.

Me kontratën e sipërmarrjes me nr. 4938 rep nr. 831 kol datë 22.05.2006 të lidhur para noterit Ruko Sako, rezultojnë se pala pronare e tokës, trashëgimtarë Begeja, të përfaqësuar nga shtetasi Jamarbër Malltezi, me objekt *“Kthimi i destinacionit të tokës nga zonë sportive në zonë për ndërtim banesa, privatizimi i objekteve ekzistuese dhe bashkëpunimi reciprok në fushën e ndërtimit për ndërtimin e një kompleksi shumëfunksional me emër Kompleksi Paschal”*, kanë lidhur kontratë me palën sipërmarrëse shoqëria e ndërtimit *“Kontakt”* sh.p.k. përfaqësuar nga shtetasi Fatmir Bektashi.

Me vendimin nr. 132 datë 08.06.2006 të kryetarit të KRRT-së, Bashkia Tiranë (nr. 277 prot datë 28.06.2006), është vendosur ndër të tjera që, të miratohet kërkesa për ndryshim të destinacionit për zonën Rruga *“Frosina Plaku”* dhe rruga e Planit Rregullues nga zonë sportive në zonë banimi. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga KRRT-ja.

KRRT-së e kryesuar nga shtetasi Sali Berisha, me vendimin nr. 4 datë 21.11.2006 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë *“Për miratimin e ndryshimit në planin rregullues të Qytetit të Tiranës në lidhje me zonimin funksional për disa zona të qytetit”* përfshihet dhe zona me sipërfaqe 0.7 ha në Rrugën *“Frosina Plaku”*, e cila ndryshohet nga *“zonë sportive”* në *“zonë banimi”*.

Këshilli i Ministrave ka propozuar ndryshimin e ligjit nr. 9235 datë 29.07.2004 *“Për kthimin dhe kompensimin e pronës”* të ndryshuar. Ligji mbi të cilin u miratuan këto propozime, konkretisht nr. 9583 datë 17.07. 2006, ndryshoi nenin 17 pika 1, duke sanksionuar se subjektet e shpronësuara për fitimin e të drejtave të parashikuara nga ky ligj, kanë të drejtë të depozitojnë kërkesa të reja deri në datën 1 tetor 2007. Ky ligj është botuar në FZ nr. 81 datë 02.08.2006 duke hyrë në fuqi më datë 17.08.2006.

Ky ndryshim i dha mundësi pesë familjeve pronare Begeja, Alimehmeti, Saliaga, Vaqari dhe Llagami t'i drejtoheshin Agjencisë së Kthimit të Pronave, me kërkesa për kthimin e pronës të ndodhur në territoret e Klubeve Sportive (të Futbollit dhe Shumësportesh) Partizani.

Në vijim, Këshilli i Ministrave ka propozuar ndryshimin e ligjit nr. 9235 datë 29.07.2004 *“Për kthimin dhe kompensimin e pronës”* të ndryshuar. Ligji mbi të cilin u miratuan këto propozime, konkretisht nr. 9583 datë 17.07. 2006, sanksionoi në nenin 6, pika 1c se *Subjekteve të shpronësuara u kthehen të gjitha pronat e paluajtshme në pronësi apo përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes, por që janë jashtë strukturës së Forcave të Armatosura, të miratuara nga Presidenti i Republikës.....*

Gjithashtu, Këshilli i Ministrave ka propozuar ndryshimin e ligjit nr. 9235 datë 29.07.2004 *“Për kthimin dhe kompensimin e pronës”* të ndryshuar. Ligji mbi të cilin u miratuan këto propozime, konkretisht nr. 9583 datë 17.07. 2006, sanksionoi në nenin 8/1,

se ... u kthehet apo u kompensohet subjekteve të shpronësuar truallë privat mbi të cilin janë ngritur ndërtime të përhershme dhe të ligjshme në pronësi të pronarit shtet, sipas rastit: a) Kur ndërtesat në pronësi të pronarit shtet nuk përdoren më për interes publik, truallë i kthehet subjektit të shpronësuar, duke i njohur atij të drejtën e parablerjes së objektit në privatizim. Deri në privatizimin e objektit sipas këtij ligji shteti detyrohet t'i paguajë subjektit të shpronësuar çmimin e qirasë për truallin që ka në posedim sipas tarifave që zbaton për dhënie me qira të trojeve shtetërore të tretëve".

Ndërkohë nuk rezulton se qartë nga vendimmarrjet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm nëse prona me nr. 11 e identifikuar si Klubi i Futbollit Partizani, është apo jo në planin e përhapjes .

Ndërkohë që me shkresën nr. 5743 prot datë 24.07.2006 të sekretarit të përgjithshëm të Drejtorisë së Privatizimit, METE, i është kërkuar Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Turizimit, të informohen në lidhje me statusin aktual (administrimin, regjistrimin, përdorimin, konfliktet e pronësisë nëse ka etj) përkatësisht të objekteve Klubi i Futbollit Partizani dhe Klubi Shumësportesh Partizani. Rezulton se me shkresën nr. 6932 prot datë 09.08.2006 zv. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral major Luan Hoxha, i adresohet Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, duke dërguar Listën e Pronave sipas Planit të Përhapjes dhe në Përdorim të FA-së me nr. 6932/3 prot datë 09.08.2006 të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, ku e fundit në rradhë është specifikuar Klubi i Futbollit Partizani, prona me nr. 11.

Me shkresën nr. 7883 datë 15.09.2006 "Për marrjen në administrim dhe regjistrimin e KF Partizani", drejtuar Komandës Mbështetëse Logjistike nga Shabi i Përgjithshëm i FA, shefi i shtabit, Gjeneral Lejtnant Pëllumb Qazimi, është parashtruar se, ...Komanda e Mbështetjes Logjistike, të marrë në përgjegjësi administrimi dhe të regjistrojë pronën me emërtimin Klubi i Futbollit Partizani, Tiranë....

Me shkresën nr. 8138/1 prot datë 05.10.2006 të Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtoria e Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes, drejtori Maliq Xhebra, me lëndë "Për regjistrimin e pronës nr. 11 me emërtim Klubi i Futbollit Partizani" Tiranë, i drejtohet Komandës Mbështetëse Logjistike, duke bërë me dije se ... në listën e pronave që përfshihen në planin e përhapjes është edhe prona me emërtimin Klubi i Futbollit Partizani, në përgjegjësi administrimi të KML-së.....

Gjithashtu nga aktet, ka rezultuar se një pasuri tjetër, e ndryshme nga Klubi i Futbollit Partizani, përfshihet në planin e përhapjes. Konkretisht sipas planit të përhapjes së FA-së nr. 231/3 prot datë 29.03.2006 rezulton se Orkestra frymore – KS Partizani, është e përfshirë në planin e përhapjes 2006 - 2010.

Me shkresat nr. 4285 datë 13.11.2006 dhe nr. 764 datë 25.02.2007 drejtuar ZVRPP Tiranë, Komanda Mbështetëse, ka aplikuar për regjistrimin e pronës Klubi i Futbollit Partizani. Ndërkohë, Komanda Mbështetëse, pretendon se me gjithë ndërhyrjet e herë pas herë pranë ZVRPP Tiranë, nga kjo zyrë nuk është dhënë dokument pronësie me pretendimin se ka mbivendosje dhe është në proces gjyqësor.

Komanda Mbështetëse pretendon se DMIBM në Ministrinë e Mbrojtjes, me shkresën nr. 349/2 datë 09.03.2007 "Përgjigje kërkesës për konfirmim prone" drejtuar ZRKKP Tiranë dhe për dijeni Komandës Mbështetëse, është shprehur se për t'i hapur rrugë procedurave të kthimit dhe kompensimit të pronave, si dhe për të mos krijuar përplasje mbivendosje në pronësi ... tërheqin vëmendjen që të gjitha kërkesat në lidhje me regjistrimin e pronave në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes të bëhen pas miratimit të Ministrisë.

(Shih shkresën nr. 1487/1 regj datë 19.03.22009 të Komandës Mbështetëse). Ndodhur në këto kushte Komanda Mbështetëse ndërpreu procedurën e regjistrimit të pronës dhe me shkresën nr. 913/1 datë 20.03.2007 "Njoftim për regjistrimin e pronës nr. 11 Klubi i Futbollit Partizani" drejtuar DMIBM në MM kërkoi që kjo pronë të hiqej nga administrimi i Komandës Mbështetëse. Prona nr. 11 deri më sot nuk është marrë në dorëzim nga Komanda Mbështetëse. (Shih shkresën nr. 1487/1 regj datë 19.03.22009 të Komandës Mbështetëse).

Gjithashtu, Këshilli i Ministrave ka propozuar ndryshimin e ligjit nr. 9235 datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" të ndryshuar. Ligji mbi të cilin u miratuan këto propozime, konkretisht nr. 9583 datë 17.07.2006, ndryshoi varësinë e Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, ku anëtarët e tij që emëroheshin dhe shkarkoheshin nga Kuvendi, suprimohej, duke u krijuar sipas nenit 15, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si person juridik publik, ku mënyra e organizimit dhe e funksionimit të saj si dhe procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuar, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

Me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 566 datë 23.08.2006 "Për organizimin dhe funksionimin e AKKP", ku sipas pikës 4 të kësaj VKM-je, organika dhe struktura e AKKP-së përcaktohen me urdhër të kryeministrit me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

Sipas parashikimeve të pikës 5/1, Drejtori i Përgjithshëm, përveç detyrave dhe përgjegjësi të parashikuara në ligj, ushtron dhe këto përgjegjësi: ...ç) Raporton, informon dhe i relatton për veprimtarinë e agjencisë ministrit të Drejtësisë, si dhe zbaton udhëzimet e tij;...

Sipas pikës 6, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, ndërsa 2 zëvendës drejtorët emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

Kryeministri, në urdhrin e emërimit, përcakton zëvendës drejtorin përgjegjës, i cili në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm, ka të drejtën të ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë, për përfaqësimin e AKKP-së, për çështjet e përcaktuara në nenin 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, të ndryshuar.

Sipas pikës 7, Drejtuesit e zyrave rajonale emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë. Ata përzgjidhen ndërmjet kandidatëve, shtetas shqiptarë, të aftë profesionalisht, me përvojë në drejtim dhe me integritet të lartë personal.

Sipas pikës 9, Drejtori i Përgjithshëm i raporton, me shkrim, periodikisht, çdo tre muaj, Kryeministrit dhe Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financën, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ku ndërmjet të tjerave evidentohet se raportohen edhe: ...gj) të dhënat për çdo çështje tjetër, për të cilën kërkohet informacion apo që, sipas vlerësimit të Drejtorit të Përgjithshëm, duhet të vihet në dijeni Kryeministri dhe/apo komisioni përkatës i Kuvendit. ...

Ndërkohë, sipas pikës 10, Drejtori i zyrës rajonale u raporton me shkrim, çdo muaj, Drejtorit të Përgjithshëm dhe Prefektit të Qarkut. Raporti përmban ndërmjet të tjera sipas gërmës e) të dhëna për çdo çështje tjetër, për të cilën kërkohet informacion apo që,

(Shih shkresën nr. 1487/1 regj datë 19.03.22009 të Komandës Mbështetëse). Ndohur në këto kushte Komanda Mbështetëse ndërpreu procedurën e regjistrimit të pronës dhe me shkresën nr. 913/1 datë 20.03.2007 "Njoftim për regjistrimin e pronës nr. 11 Klubi i Futbollit Partizani" drejtuar DMIBM në MM kërkoi që kjo pronë të hiqej nga administrimi i Komandës Mbështetëse. Prona nr. 11 deri më sot nuk është marrë në dorëzim nga Komanda Mbështetëse. (Shih shkresën nr. 1487/1 regj datë 19.03.22009 të Komandës Mbështetëse).

Gjithashtu, Këshilli i Ministrave ka propozuar ndryshimin e ligjit nr. 9235 datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" të ndryshuar. Ligji mbi të cilin u miratuan këto propozime, konkretisht nr. 9583 datë 17.07.2006, ndryshoi varësinë e Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, ku anëtarët e tij që emëroheshin dhe shkarkoheshin nga Kuvendi, suprimohej, duke u krijuar sipas nenit 15, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si person juridik publik, ku mënyra e organizimit dhe e funksionimit të saj si dhe procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

Me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 566 datë 23.08.2006 "Për organizimin dhe funksionimin e AKKP", ku sipas pikës 4 të kësaj VKM-je, organika dhe struktura e AKKP-së përcaktohen me urdhër të kryeministrit me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

Sipas parashikimeve të pikës 5/1, Drejtori i Përgjithshëm, përveç detyrave dhe përgjegjësi të parashikuara në ligj, ushtron dhe këto përgjegjësi: ...ç) Raporton, informon dhe i relaton për veprimtarinë e agjencisë ministrit të Drejtësisë, si dhe zbaton udhëzimet e tij;...

Sipas pikës 6, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, ndërsa 2 zëvendës drejtorët emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

Kryeministri, në urdhrin e emërimit, përcakton zëvendës drejtorin përgjegjës, i cili në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm, ka të drejtën të ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë, për përfaqësimin e AKKP-së, për çështjet e përcaktuara në nenin 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, të ndryshuar.

Sipas pikës 7, Drejtuesit e zyrave rajonale emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë. Ata përzgjidhen ndërmjet kandidatëve, shtetas shqiptarë, të aftë profesionalisht, me përvojë në drejtim dhe me integritet të lartë personal.

Sipas pikës 9, Drejtori i Përgjithshëm i raporton, me shkrim, periodikisht, çdo tre muaj, Kryeministrit dhe Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financën, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ku ndërmjet të tjerave evidentohet se raportohen edhe: ...gj) të dhënat për çdo çështje tjetër, për të cilën kërkohet informacion apo që, sipas vlerësimit të Drejtorit të Përgjithshëm, duhet të vihet në dijeni Kryeministri dhe/apo komisioni përkatës i Kuvendit. ...

Ndërkohë, sipas pikës 10, Drejtori i zyrës rajonale u raporton me shkrim, çdo muaj, Drejtorit të Përgjithshëm dhe Prefektit të Qarkut. Raporti përmban ndërmjet të tjera sipas gërmës e) të dhëna për çdo çështje tjetër, për të cilën kërkohet informacion apo që,

(e cila ka nisur në janar të vitit 2007) është konkluduar me kryerjen e të gjitha verifikimeve nga AKKP dhe është vendosur kthimi i pronave për 4 familje pronare.

Pikërisht, vetëm disa muaj pas kthimit të pronave familjeve pretenduese, si më sipër cituar (vendimet kanë marrë formë të prerë në muajin maj 2007), Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri Genc Ruli, me shkresën Nr.50/1 Prot, datë 19.09.2007, i ka dërguar Ministrin të Mbrojtjes, Fatmir Mediu duke vënë në djeni Degen e Shoqërive Publike, se miraton privatizimin e terreneve sportive dhe objekteve të Klubit të futbollit "Partizani" duke i kërkuar që të përgatitet dokumentacioni për vlerësimin në zbatim të VKM-së Nr.704, datë 11.10.2006 dhe VKM-së 703, datë 11.10.2006 për kriteret dhe procedurat e shitjes.

Ndërkohë rezulton se në ligjin nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për Sportin", neni 31 në këtë kohë parashikonte kufizimin mbi destinacionin e objekteve sportive dhe destinacionin edhe pas privatizimit në këtë mënyrë: "1. Ndryshimi i statusit të objekteve sportive, në varësi të pushtetit qëndror a vendor, bëhet në përputhje me ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare; 2. Objektet sportive jepen me koncesion apo privatizohen, me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni, në përputhje me ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë".

Pasi miratohet privatizimi i Klubit të Futbollit Partizani, Këshilli i Ministrave propozon ndryshime në ligjin nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për Sportin" ndryshime këto të miratuara me ligjin nr. 9816 datë 22.10.2007. Sipas këtyre ndryshimeve, neni 31 ndryshon duke u parashikuar se: "Objektet sportive jepen me koncesion, me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni, në përputhje me ligjin nr. 9663 datë 18.12.2006 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë".

Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, Genc Ruli, Drejtoria e Privatizimit me shkresën Nr. 9508 Prot. datë 18.12.2007 ka ngritur komisionin e vlerësimit për privatizimin e Klubit të Futbollit Partizani, ku ekspert vlerësues caktohet shtetësja Elvira Aliaj dhe ekspert kontabël caktohet shtetasi Sali Preçi.

Përpos sa sipër, privatizimit të klubit të futbollit "Partizani" familjet pronare kanë vijuar me procedurat e privatizimit edhe për "Klubin Shumësportesh Partizani" dhe për këtë qëllim i janë drejtuar me kërkesën nr. 1226 prot datë 26.12.2007 Ministrin të Turizmit Ylli Pango dhe për djeni Ministrin të Ekonomisë Genc Ruli i paraqitet kërkesë nga Bashkësia Kroi i Shëngjinit, për ushtrimin e të drejtës së privatizimit për Klubin Shumësportesh Partizani.

Pikërisht në këtë kohë, shtetasi Jamarbër Malltezi është caktuar përfaqësues edhe për trashëgimtarë të tjerë të familjeve pronare, shtetasve Nervit Hoxha, Raimonda Bekteshi që përfaqësohen nga Bashkim Bekteshi dhe vetë shtetasi Bashkim Bekteshi, siç rezulton nga prokura nr. 10086 rep nr. 1542 kol datë 31.12.2007, para noterës Ruko Sako.

Me shkresën Nr. 12248/1 Prot, datë 04.01.2008 Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me Ministër Z. Ylli Pango, shprehet dakort për privatizimin e Klubit Shumësportesh "Partizani" dhe kjo shkresë i Drejtohet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës me Ministër Z. Genci Ruli.

Me shkresën Nr. 953/1 Prot. datë 22.01.2008, me lëndë "Miratim Privatizimi", Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës Genc Ruli i drejtohet Ministrisë të Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Ylli Pangos dhe për djeni shtetasit Irfan Hoxha, Degës së Shoqërive Publike dhe Familjes Begeja. Në përmbajtje të kësaj shkresë në përgjigje të shkresës Nr.

12248/1 Prot, datë 04.01.2008 është miratuar privatizimi i Klubit Shumësportësh "Partizani".

Me shkresën Nr. 1247 Prot, datë 04.02.2008 Ministri Genc Ruli, i është drejtuar shtetasit Irfan Hoxha si kryetar i Degës së Shoqërive Publike, shtetasit Afrim Tola si drejtor i Klubit Shumësportësh Partizani, Elivira Aliaj si ekspere vlerësuese dhe Sali Preçi si ekspert kontabël i autorizuar, me objekt "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit për privatizimin e objektit Klubi Shumësportësh Partizani Tiranë", ... duke urdhëruar ngritjen e komisionit të vlerësimit ku evidentohet se ekspert vlerësues dhe kontabël caktohen të njëjtët persona si në rastin e Klubit të Futbollit Partizani, konkretisht shtetasit Elvira Aliaj dhe Sali Preçi.

Më datë 07.05.2008 është përgatitur raporti i vlerësimit nga ekspertët Elvira Aliaj dhe Sali Preçi për Klubin Shumësportësh Partizani dhe Pishina e Klubit Shumësportësh rruga e Durrësit, Laprakë, Tiranë, në përfundim të së cilit është konkluduar sipërfaqja totale e truallit është 18 211 m<sup>2</sup> nga ku sipërfaqja funksionale 13 934 m<sup>2</sup>, sipërfaqja nën objektet legale 4 277 m<sup>2</sup>, sipërfaqja e ndërtimit është 5 518 m<sup>2</sup> kurse pishina e notit + zyra e palestra e notarëve, sipërfaqja e truallit sipas inventarit (duke hequr ato të cilat janë përdorur e do përdoren për qëllime publike, në rastin konkret rikonstruksion infrastrukturë rrugore sipas planit rregullues) është 880 m<sup>2</sup> e sipërfaqja nën objektin në inventar është 0 m<sup>2</sup>. Evidentojnë ndër të tjera se për territorin mbi të cilin ka qenë ndërtuar pishina e notit në Laprakë kjo pronë, truall me sipërfaqja 1200 m<sup>2</sup>, mban nr. 12/27 dhe figuron e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Esat Pira dhe Marita Osmani. Ky regjistrim ka mbivendosje me pasuritë me nr. 12/25 dhe 12/28.

Në përfundim të raportit të vlerësimit, grupi i ekspertëve përcakton se: Vlera reale e tregut për pronën shtetërore në privatizim Klubi Shumësportësh Partizani është shuma totale 549 089 037 lekë e cila e ndarë në vlera të veçanta sipas elementëve të pasurisë është: Ndërtesa – vlera 43 254 740 lekë; Trualli – 505 834 297 lekë; Mjetet e xhiros – 0. Gjithsej 549 089 037 lekë.

Me shkresën nr. 169 prot datë 12.05.2008 të Degës së Shoqërive Publike, Kryetari Irfan Hoxha, i ka dërguar METE-s, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Tregtare, Drejtorisë së Privatizimit Tiranë, kopje të dokumentacionit të vlerësimit për privatizimin e objektit Klubi Shumësportësh Partizani, Tiranë, njësi në administrim të Ministrisë së Turizimit, miratuar e shkresën nr. 953/1 datë 22.01.2008 të METE. Mjete kryesore në lekë - 43 254 740 lekë; Vlera e truallit në lekë 505 834 297 lekë.

Më datë 19.05.2008 themelohet shoqëria "Homeplan" sh.p.k. e cila regjistrohet më datë 03.06.2008 me NIPT K81803020E, nga ortaku i vetëm Fatmir Bektashi, me objekt ndërtim dhe kryerje e operacioneve ndërtim pasurish të paluajtshme, blerje, shitje etj. Administrator i kësaj shoqërie është shtetasi Fatmir Bektashi.

Me shkresën e METE nr 4660/1 prot datë 20.05.2008 Ministri i Ekonomisë, Genc Ruli, i ka përcjellë Ministrisë së Financave Drejtorisë së Administrimit dhe shitjes së Pronave Publike, dokumentacionin e vlerësimit për privatizimin e Klubit Shumësportësh Partizani Tiranë.

Me memon datë 26.05.2008 shefi i sektorit të shitjes së pronave shtetasi Nuri Sopaj i është drejtuar shtetasit Urim Muja, me detyrë drejtor duke i dërguar informacion lidhur me fillimin e procedurave ligjore për privatizimin e objektit Klubi Shumësportësh Partizani. Përpos të tjerave i është bërë me dije se për pronësinë e truallit dhe HTR për objektin Pishina Laprakë, rezulton me mbivendosje me dy bashkëpronarë, pra rezulton të jetë private.

Me shkresën nr. 5309/3 prot datë 29.05.2008 të drejtorit Urim Muja, drejtuar METE, kërkohet prononcim për privatizim objekti të Klubit Shumësportesh Partizani. I Bëhet me dije ndër të tjera se për një pjesë e territorit të këtij objekti bashkë me objektet e ndërtuara mbi të, është zonë sportive. Përsa më sipër kërkohet nga ana e METE të konfirmojnë nëse objektet e dërguara për privatizim vazhdojnë të jenë objekte sportive apo e kanë humbur funksionin e tyre si të tilla.

Me shkresë Nr. 4660/3 Prot. datë 02.06.2008, Drejtoria e Privatizimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës i ka përcjellë Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, gjithë dokumentacionin në lidhje me terrenet e objektit "Klubi shumësportësh Partizani"

Në këtë periudhë që kanë ndodhur qoftë miratimi i privatizimit të Klubit Shumësportesh Partizani ashtu edhe procedurat në lidhje me këtë privatizim, si vlerësimi, shqyrtimi i dosjes etj, sipas nenit 31 të ligjit "Për Sportin" objektet sportive nuk mund të privatizoheshin por mund të jepeshin vetëm me koncension.

Këshilli i Ministrave, me VKM nr. 906 datë 18.06.2008, e nënshkruar nga Kryeministri Sali Berisha, dhe Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Ylli Pango, depozituar në Kuvend me nr. 2344 datë 02.07.2008, ripropozon ndryshime në ligjin nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për sportin" të ndryshuar, ndryshime këto të miratuara me ligjin nr. 9963 datë 21.07.2008.

Sipas këtyre ndryshimeve, neni 31 rindryshohet në këtë mënyrë: *Objektet sportive privatizohen nga pronarët e truallit, kur ka të tillë, në të kundërt jepen me koncension, në përputhje me ligjin nr. 9663 datë 18.12.2006 "Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë" me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni.* Ky ndryshim i fundit është botuar në FZ më datë 01.08.2008, duke hyrë në fuqi më datë 16.08.2008.

Vetëm një ditë pas vendimit të Këshillit të Ministrave për propozimin e këtyre ndryshimeve, ekspertët Elbira Aliaj dhe Sali Preçi, përgatisin më datë 19.06.2008, Raportin e Vlerësimit për Klubin e Futbollit "Partizani", Tiranë. Në këtë raport vlerësimi ata evidentojnë se nga matjet në terren, bazuar edhe në konfirmimin e Bashkisë Tiranë, sipërfaqja totale e truallit të pronës Klubi i Futbollit Partizan është 26 524 m<sup>2</sup>. Bazuar në shkresën e ZVRPP brenda Begeja, Vaqarri që mbulojnë me këto pronësi sip totale 22 263 m<sup>2</sup> dhe mbi sip prej 4261 m<sup>2</sup>, është pronar shteti. Pasur parasysh zonën, ekspertët kanë vlerësuar se, çmimi për 1 m<sup>2</sup> truall është 26 787 lekë ose për të gjithë territorin 710 498 388 lekë. Pra sipas këtyre përlllogaritjeve, për sipërfaqen prej 4261 m<sup>2</sup>, pronarët duhet të paguanin edhe shumën prej 114 139 407 lekë. Si referencë për vlerën kontabël është marrë ajo e pasqyruar në dokumentacionin e vënë në dispozicion e cila ka rezultuar nga rivlerësimi i fundit i bërë në vitin 1997. Shuma totale 720,607,168 lekë e cila është e ndarë në vlera të vecanta: Ndërtesa (10,108,780 lekë), Trualli (710,493,388 lekë).

Me shkresën nr. 6554 prot datë 25.06.2008 drejtori Urim Muja, i DASHPP i dërgon Degës së Shoqërive Publike, materialin për njoftim me afishe për privatizim objekti të Klubit Shumësportesh Partizani.

Me shkresën nr. 72/13 prot datë 27.06.2008 Dega e Shoqërive Publike, i përcjell METE-s, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Tregtare, Drejtorisë së Privatizimit Tiranë, dy kopje të dokumentacionit të vlerësimit për privatizimin e terreneve sportive dhe objekteve të Klubit të Futbollit Partizani, njësi nën administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar me